



Key Action 1
– Mobility for learners and staff –

**Hapet Thirrja për mobilitete stafi të UPT-së
në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus+
në University of Applied Sciences në Nysa, Poloni.**

Në kuadër të marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për mobilitete për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në UAS in Nysa

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e stafit akademik për pjesëmarrje javën Ndërkombëtare të stafit (*the 16th International Staff Training Week*).

Staf akademik nga të gjitha njësitë. Nominimi përfundimtar kryher nga universiteti pritës, pas konfirmimit të mobiliteteve.

Numri total i stafit akademik për mësimdhënie: 5

Koha e kryerjes së mobilitetit: 5+2 ditë, 18 – 22 maj 2026

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës*;
- Planin e Mobilitetit (Mobility Agreement);
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for **Teaching**) për stafin akademik në universitetin pritës**.

**Plani i mobilitetit, si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

*** Mobility Agreement for Teaching për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Stafi pjesëmarrës në mobilitet, mbas përfundimit të tij, duhet të paraqesë një raport lidhur me aktivitetin, te departamenti përkatës dhe te Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, si dhe dokumentacionin e përfundimit të mobilitetit.

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 27 mars 2026, ora 12.00.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al, abeqo@upt.al.